

## RIKRIJIMI DHE RIMODELIMI I BARASVLERËSVE PËRKTHIMORË NË GJUHËN SHQIPE

**VIKTOR RISTANI**

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Anglishtes, Tiranë, Shqipëri  
Email: vristani@gmail.com

### **Përmbledhje:**

Në këtë artikull, në kuadrin e Studimeve Përkthimore, në përgjithësi, dhe kritikës së përkthimit në veçanti, duke i kushtuar rëndësi përcaktimit të fazave të planit të kritikës, do të përqëndrohemi në disa prej strategjive dhe taktikave përkthimore të shfrytëzuara nga përkthyesi i mirënjohur Skënder Luarasi, gjatë përkthimit të romanit "Oliver Twist", vepër e shkrimtarit të mirënjohur anglez Çarls Dikens, në procesin e ristrukturimit dhe përcjelljes së barasvlerësve përkthimorë dhe funksionalë. Në këtë kontekst, do të analizojmë metodat e përkthimit dhe përftesat përkthimore të tilla si transpozimi dhe barasvlefshmëria, të përdorura mjeshtërisht gjatë rikrijimit dhe rimodelimit të barasvlerësve kuptimorë dhe stilistikë, në përputhje me kërkesat e parimit të krijimit të efektit të barasvlefshëm. Duke shpalosur parimin "si mund të përkthehet dhe jo si duhet të përkthehet vepra letrare" do të theksojmë se procesi i përkthimit nuk presupozon paraqitjen dhe imponimin e vetëm një mënyre përkthimore, por alternativave të shumëllojshme. **Fjalë çelës:** studime përkthimore, kritikë përkthimore, vlerësim i përkthimit, barasvlerës përkthimorë dhe funksionalë, përftesë përkthimore.

### **Summary**

In this article, within the framework of Translation Studies, in general, and translation criticism, in particular, through paying attention to the relevant stages of the translation criticism plan, our special focus will be on some of the translation strategies and tactics employed by our renowned translator Skënder Luarasi in translating the novel "Oliver Twist" written by the well-known English novelist Charles Dickens, in the process of restructuring and transferring the translation and functional equivalents. In this context, our analysis will focus on the translation methods and translation procedures, such as transposition and equivalence, skillfully and dexterously manipulated in the course of recreating and recasting the respective semantic and

stylistic equivalents, in compliance with the requirements of the equivalent effect principle, thereby unfolding the principle "how the literary work could be translated, but not how it should have been translated", likewise emphasizing that translating does not presuppose the introduction and imposition of one translation mode only, but multiple alternatives.

**Key words:** translation studies, translation criticism, translation assessment, translation and functional equivalent, translation procedure.

### **Kritika përkthimore dhe vlerësimi i përkthimeve**

#### **1.1. Hyrje**

Studimet përkthimore, për vetë natyrën shumëdisiplinore të tyre, duke përfshirë edhe vlerësimin e kritikën e përkthimeve, shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet teorisë dhe praktikës përkthimore. Vlerësimi i përkthimeve dhe kritika përkthimore mund të trajtohet nga këndvështrime të ndryshme. Duke respektuar përkthyesin, rekomandohet të hidhet dritë mbi këtë çështje dhe të theksohen metoda, përftesat përkthimore dhe elementët e tjerë të procesit të përkthimit. Nga ana tjetër, duhet të merret parasysh fakti se më e përshtatshme dhe etike është që përkthyesit të mos vlerësohen në përputhje me parimet dhe metodat përkthimore, të cilat, në kohën kur u kryhen përkthimet, nuk ekzistojnë, ose as që mund të konceptoheshin, duke mos "fajësuar" përkthyesin ose përkthyesit për mosnjohjen dhe moszbatimin e kërkesave dhe parimeve përkthimore të sotshme (Ristani, 2004: 278).

Për shkak të interesit që paraqesin marrëdhëniet ndërmjet gjuhëve dhe kulturave, përkthimit dhe studimeve përkthimore, në raport me vlerësimin dhe kritikën përkthimore, në këtë kumtesë, duke qëmtuar shëmbuj të ndryshëm të përkthimit letrar, do të përqëndrohemi shkurtimisht në parashtrimin e çështjeve kryesore që lidhen me vlerësimin e përkthimit dhe mënyrën se si zbatohen kërkesat e parimit të krijimit të efektit të barasvlefshëm, në procesin e ristrukturimit dhe

ristrukturimit të vlerave gjuhësore, kulturore dhe njohëse gjatë përkthimit të veprave letrare nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

### Kritika përkthimore

#### Modelet

Në lidhje me vlerësimin dhe kritikën përkthimore dallohen lehtësisht dy modele, përkatësisht modelet krahasimore dhe modelet jokrahasimore. Shumica e kritikëve të përkthimit mbështeten në krahasimin e tekstit në gjuhën e origjinalit me tekstin e përkthyer. Piter Njumark (Newmark, 1988), propozon modelin në të cilin parashikohen analiza tërësore të tekstit në gjuhën e origjinalit, duke theksuar qëllimin e shkrimtarit dhe qëllimin e përkthyesit, krahasimi i tekstit në gjuhën e origjinalit me tekstin e përkthyer. Ndërsa Basil Heitim dhe Jan Meisën (Hatim, 1990), përcaktojnë parametra krahasimorë të tillë si "semiotika kulturore e gjuhës", zhanret letrare, ligjërimi dhe teksti, duke u përqëndruar jo në fjalë të shkëputura, por organizime tekstore komplekse. Nga ana tjetër, në lidhje me modelet jokrahasimore, mund të vëmë në dukje se Andre Lëfevrë (Lefevre, 1991: 129-44) nuk përqëndrohet në procesin e përkthimit, por në produktin e përkthimit në kontekstin e kulturës së përkthimit, ndërsa Gidë Turi 1978 (Toury, 1978), 1980 (Toury, 1980) sugjeron modelin vlerësues bazuar vetëm në sistemin e gjuhës së përkthimit.

#### 2.2. Plani i kritikës përkthimore

Duke u mbështetur në metodën analitike të kritikës së përkthimeve dhe jo në vëzhgime të karakterit subjektivist, mund të propozonim këtë plan të kritikës përkthimore:

1. Realizimi i **analizës stilistike** tërësore të tekstit dhe përcaktimi i elementëve stilistikë kyç të tekstit në gjuhën e burimit, në varësi të niveleve dhe tipareve idiosinkretike, kategorisë së tekstit, shmangieve të qëllimshme, tonit të ligjërimin, marrëdhëniet të ligjërimin me personazhin në kuadrin e dialogut, tipareve të përngjashmuara të stileve funksionale, formave të ndryshme të adresimit, etj.

2. Përcaktimi i **metodës së përkthimit** në përputhje me synimet e përkthyesit, stilin e përkthyesit, synimet e botuesit, duke patur parasysh qëndrimin e përkthyesi ndaj figuracionit, ristrukturimit të barasvlerësve kulturorë në gjuhën e përkthimit, individualizimit të personazheve, ruajtjes së idiosinkrasive ligjërimore, krijimit të efekteve pothuaj të barasvlefshme,

"It's naughty, ain't it, Oliver?" inquired Charley Bates. "He'll come to be scragged, won't he?"

"..... thereby indicating, by a lively pantomimic representation, that *scragging and hanging were one and the same thing.* (Dickens, 1966: 183)

problemit të besnikërisë ndaj tekstit të origjinalit apo lexuesve të përkthimit etj.

3. **Krahasimi i përkthimit** me tekstin origjinal, duke u bazuar në metodën përkthimore të përdorur nga përkthyesi në periudhën kur është realizuar përkthimi, vlerësimi i përkthimit, në bazë të parimeve të përgjithëshme të teorisë dhe të praktikës përkthimore, zgjidhje stilistike të mundshme, në dritën e kërkesave dhe zhvillimeve të reja, mundësinë e ripërkthimit, apo redaktimit stilistik të përkthimeve ekzistuese.

#### Analiza stilistike. Ligjërimi realist, i papërngjashmuar

Duke ju referuar analizës tërësore stilistike, në kuadrin e planit të propozuar të kritikës përkthimore, Normën Peixh 1973 (Page, 1973:91) dallon gjashtë mënyra të përdorimit të ligjërimin në karakterizimin dhe individualizimin e personazheve, përkatësisht ligjërimi si mjet identifikimi, ligjërimi si parodi, ligjërimi real, i pamimetizuar, ligjërimi konvencional, ligjërimi simbol, ligjërimi asnjës. Në artikullin tonë, gjatë analizës dhe vlerësimit të përkthimit, do të përqëndrohemi në ligjërimin realist, të papërngjashmuar duke ju referuar përkthimit të realizuar nga përkthyesi Skënder LUARASI (Dikens, 1957). Analiza e vëmendshme e dialogut në veprat e Dikensit, pavarësisht nga përpjekjet e tij drejt përngjashmimit të ligjërimin, spikat prirjen për të shfrytëzuar mundësitë tipologjike që ofron ligjërimi nënstandard, veçanërisht në pranëvënie me ligjërimin normativ, e cila është më e dukshme në atë grupim të ligjërimin të emërtuar, *ligjërim realist, i papërngjashmuar*. Në këtë kontekst kemi parasysh dialektet gjeografike, klasifikuar në përputhje me përkatësinë e vendosjes gjeografike dhe sociolektet, ose dialektet sociale, si dhe dialektet profesionale.

#### Vlerësimi i përkthimit dhe kritika përkthimore

##### 4.1. Transpozimi

Kontrasti ndërmjet të dy botëve, botës së nëndheshme dhe botës së qytetëruar, fillimisht jepet nëpërmjet përshkrimin të shtëpive të hajdutëve, të cilat më tepër ngjani me rrugën se sa me shtëpinë. Duke krahasuar gjuhësisht të dy botët, vërejmë se edhe marrëdhëniet gjuhësore, si dhe ato sociogjuhësore tjetërsohen deri në atë shkallë sa që edhe vetë pjestarët e bandës e ndjejnë domosdoshmërinë e përkthimit dhe deshifrimin të fjalëve dhe shprehjeve të zhargonit të tyre profesional, pjesë e fshehtësisë së tyre gjuhësore, në gjuhën e zakonshme, të kuptueshme për Tuistin:

"Shumë e keqe, apo jo?" pyeti Charl Bejtsi. "Merr fund me të kolovitur, apo jo?"

"..... duke treguar kështu përmes një shëmbëlle pantomimike, se të koloviturit për zverku dhe të varurit qenë po ajo gjë. (Dikens, 1957: 131)

Fshehtësia gjuhësore në përkthim, tjetërsimi gjuhësor i bandës së Fexhinit strukturohen në gjuhën e përkthimit nëpërmjet transpozimeve të shumta, të parapëlqyera nga përkthyesi, mbi bazën e të cilave ai operon në tërësinë e përkthimit në gjuhën shqipe. Njohës i shkëlqyer i visareve të gjuhës shqipe, njohës i shkëlqyer i mundësive dhe aftësive shprehëse, të ligjërimin bisedor, duke e përshtatur ligjërimin për nivelin e lexuesve, nëpërmjet zbatimit të metodës komunikative, përkthyesi Skënder Luarasi formën pësore të foljes "scrag", përkatësisht "to be scragged", që në zhargonin e vjedhësve ka kuptimin "to be hanged", e përkthen me

"And always put this in your pipe, Nolly" said the Dodger, as the Jew was heard unlocking the door above, "if you don't take fogles and tickers - "

"If you don't take pocket-handkerchers and watches, " said the Dodger, reducing his conversation to the level of Oliver's capacity, ... (Dickens, 1966: 183-84)

Respektimin e kërkesave të metodës semantike, respektimin e njësive ligjërimore në mbrytjen e variantit të përkthyer, zbërthimin e tekstit në njësi më të vogla përkthimore në kuadrin e tërësisë tekstuale, i ndeshim edhe në shëmbujt e sipërcituar. Në frymën e ligjërimin të gjallë dhe të figurshëm, përkthyesi parapëlqen përkthimin e figurës me barasvlerës të figurshëm, të pranishëm në gjuhën e përkthimit, duke përkthyer put this in your pipe - fute në kungullin tënd këtë, ndërsa ligjërimin të fshehtë i përgjigjet me elementë të ligjërimin të fshehtë, përkatësisht "if you don't take fogles and

... and the conversation took a very convivial and improving turn. At length, Charley Bates expressed his opinion that it was time to pad the hoof. This, it occurred to Oliver, must be French for going out; for, directly afterwards, the Dodger, and Charley, and the two young ladies, went away together, ... (Dickens, 1966: 111)

Të njejtën situatë ligjërimore strukturën në gjuhën shqipe edhe përkthyesi, në procesin e përzgjedhjes së mjeteve gjuhësore, përcaktimit të semantikës, në përputhje me tonin e përgjithshëm të romanit, në mënyrë që të përcjellë në gjuhën shqipe fshehtësinë ligjërimore të botës së nëndheshme të katakombëve, nëpërmjet shfrytëzimit racional të figurshmërisë së elementëve gjuhësorë dhe përcjelljes me besnikëri të situatës ligjërimore, në mënyrë që të ruhen vlerat shprehëse të origjinalit.

shprehjen e kombinuar të ligjërimin bisedor dhe dialektor "merr fund me të kolovitur", ose të përpunuar në trajtën të koloviturit për zverku, shprehje tepër të goditura në të cilat përfshihen fshehtësia e ligjërimin si dhe gjallëria e shprehësia e imazheve të ligjërimin.

Pavarësisht përpjekjeve të tij të vazhdueshme për të deshifruar ligjërimin e bandës së vjedhësve, për Oliverin e vogël vështirësitë janë të shumta. Prandaj, në momente të caktuara, vjedhësit kujtohen dhe bëhen në një farë shkalle të kuptueshëm për Oliverin, "reducing the conversation to the level of Oliver's capacity":

"Dhe fute në kungullin tënd këtë, Nolli" tha Batakçi kur Çifuti u dëgjua tek çelte derën lart; "po nuk deshe të nxjerrësh fshesa dhe çikërrima - ".

"Po të mos i marrësh ti shamitë dhe sahatet", tha Batakçi, duke zbritur bisedën e tij në aftësitë mendore të Oliverit, ... (Dikens, 1957: 131-32)

tickers" përkthehet "po nuk deshe të nxjerrësh fshesa dhe çikërrima". Gjithashtu, duke qënë se në të përmbahen trajta të ligjërimin nënstandard, në gjuhën e përkthimit shfrytëzohen trajtat e paplota, fjalitë e shkurtra dhe format e ligjërimin bisedor.

Në raste të tjera vërejmë se këtë "përkthim" në favor të lexuesve, për shkak të vështirësisë së konsiderueshme që paraqet, e realizon vetë Dikensi nëpërmjet përshkrimit të veprimeve dhe krijimit të situatës përkatëse. Ndërkohë Oliverit i dukej sikur anëtarët e bandës flisnin frëngjisht:

... dhe biseda mori një drejtim më të mirë dhe më të gjallë. Më në fund Charl Beitsi shprehu mendimin se pat ardhur koha t'ua mbathnin këmbëvet. Kjo, kujtoi Oliveri, do të thotë në gjuhën frëngjishte "të dalësh për shëtitje"; se përnjëherësh, Batakçi, Sharli dhe të dy zonjushat duallën jashtë së bashku, ... (Dikens, 1957: 69)

#### 4.2. Barasvlefshmëria ose përkthimi i barasvlefshëm

Ndonse anëtarët e bandës së vjedhësve përdorin gjuhën e tyre të fshehtë dhe të koduar, përsëri i ruhen çmistifikimit të këtij kodi, gjë që e shfaqin në panikun tipik në raste të caktuara. Pikërisht kjo frikë shprehet me mjete gjuhësore në komunikimin ndërmjet tyre ose me ndryshimin e tonalitetit të zërit, duke përdorur tërë spektrin e mundshëm të komunikimit.

"About *the crib at Chertsey*, Bill?" said the Jew, drawing the chair forward, and speaking in a very low voice.

"Yes. Wot about it?" inquired Sikes.

"Ah, you know what I mean, my dear," said the Jew....

"No, he don't," sneered Mr. Sikes. "... don't sit there, winking and blinking, and talking to me in hints, ...

"Hush, Bill, hush!", said the Jew, ... "*somebody will hear us, my dear. Somebody will hear us.*" (Dickens, 1966: 188)

"Për atë punën në Çerts, Bill!" tha Çifuti duke afruar karrekllën e duke folur me zë t'ulët.

"Po. Ç'mendon?" pyeti Saiksi.

"A, ju e dini se ç'mendonj unë, i dashur", tha Çifuti...

"Jo nuk e di", u përgjegj Saiksi me të ngërdheshur....

Ç'po më rrini aty, e më bëni me sy dhe më flisni me shenja, ...

"Sh-sh, Bill!" tha Çifuti... "*Ndokush mund të na dëgjonjë, i dashur. Ndokush mund të na dëgjonjë!*" (Dikens, 1957: 136)

Pasi ia nënshtron tekstin analizës së mësipërme, përkthyesi dallon elementët dhe njësitë gjuhësore që paraqesin interes dhe vështirësi nga pikëpamja përkthimore, prandaj, sipas mendimit tonë, përqëndrohet në fjalë dhe shprehje të tilla si p.sh. *the crib at Chertsey, drawing the chair forward, "Hush, Bill, hush!", "sneer"*, etj. Në këtë segment të kontekstit më të gjërë të veprës, frazë kyç është "*the crib at Chertsey*", të cilën përkthyesi, duke huazuar elementë të ligjëritimit bisedor të pamimetizuar, e përkthen "*atë punën në Çerts*", duke nënkuptuar një çështje për të cilën vetëm ata janë të informuar. Gjithashtu në kuadrin e shfrytëzimit të gamës së gjërë të përftesave përkthimore, vërejmë përdorimin me sukses të përftesave të tilla si barasvlefshmëria dhe natyrshmëria, si p. sh., në rast se anglezët përdorin formën "*Hush, Bill, hush!*", për shqiptarin formë e natyrshme është trajta "*Sh-sh, Bill!*". Krahas këtyre përftesave, ashtu si edhe në raste të tjera, përkthyesi përdor analizën komponentiale, ose shpërbërjen semantike. Kështu, duke ditur se folja "*sneered*" përmban dy elementë, reagimin fizik të ngërdheshjes dhe atë gjuhësor të përgjigjes, në gjuhën shqipe e përkthen "*u përgjegj me të ngërdheshur*". Gjithashtu, në mënyrë që ligjërimi të zhvendoset në planin horizontal, dialektor, duke sinjalizuar përkatësinë e ligjëritimit nënstandard, përkthyesi zbaton mjetet morfologjike të shënuara, si p. sh. tek foljet "*mendonj, dëgjonjë*", etj., ose trajtën dialektore, të vjetëruar tashmë, "*karrekëll*", në vend të trajtës "*karrike*".

### Bibliografia

- DICKENS, Charles (1966), *Oliver Twist*. London: Penguin English Library.
- DIKENS, Çarls (1957), *Oliver Tuisti*, përktheu Skënder Luarasi. Tiranë: Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve.
- HATIM, Basil and Ian MASON (1990), *Discourse and the Translator*. London: Longman Group Ltd.
- LEFEVERE, Andre (1991), Translation and comparative literature: The search for the center. TTR. Traduction Terminologie, Redaction 4, 1, 129-44.
- MARTÍNEZ Melis, N, HURTADO Albir, A. (2001), Assessment In Translation Studies: Research Needs" Meta : Journal des traducteurs / Meta: Translators' Journal, vol. 46, n° 2, 272-287.
- NEWMARK, Peter (1988), *A Textbook of translation*. New York, London: Prentice Hall International (UK) Ltd.
- NEWMARK, Peter (1984), *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon Press.
- PAGE, Norman (1973), *Speech in the English Novel*, London: Longman.
- RISTANI, Viktor (2004), »Barasvlefshmëria funksionale e idiolektike përkthimit të letërsisë artistike«, "*Sfidë*", botim i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetit Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2: 278.
- TOURY, Gideon (1978), The nature and role of norms in literary translation. In J. Holmes, J.Lambert, R. Van den Broeck (eds) *Literature and Translation: New Perspectives in Literary Studies*. Leuven: ACCO.
- TOURY, Gideon (1980), *In Search of a Theory of Translation*. Tel Aviv: Porter Institute.